





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.69/350-4108 datë 10.02.2023
REFERENC-Ë:	07Nr.350-4108 datë 16.01.2023
PËR/TO:	Rexhep Nuredin Gashi, me përfaqësues "Gjini Constuction" SH.P.K
KOPJE PËR/:	Drejtorinë e Inspeksionit Arkivin e Drejtorisë Arkivin e Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Suharekë
	<i>DREJTOR I DREJTORISË:</i> Visar KUÇI <i>Zyrtare e lartë për ndërtimtari:</i> Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-4108 datë 16.01.2023 nga Rexhep Nuredin Gashi me përfaqësues "Gjini Construction" SH.P.K nga Suhareka sipas kontratës për shtiblerjen me kompensim të pasurisë së paluajtshme Nr.LRP.8217/2022 dhe Nr.Ref.1818/2022 datë 20.05.2022, me të cilën ka kërkuar Kushte ndërtimore për ndërtimin e objektit me destinim Objekt individual me një njësi banimore, në Lagjen Rosula në Suharekë, në parcelën ndërtimore të planifikuar me HZK, të specifikuar sipas skicës së terrenit me numër të lëndës Nr.30/2023 hartuar nga Adriatik Fetiu – gjeodet i licensuar me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 405 m², pjesë e parcelës kadastrale 02934-7, me sipërfaqe të parcelës kadastrale 405m², sipas çertifikatës me Nr.131-2023 datë 11.01.2023 pronë private e Rexhep (Nuredin) Gashi. Andaj ky organ pas shqyrtimit të kërkesës ka vendosur si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj Shkrese.

AKTVENDIM MBI KUSHTE NDËRTIMORE

Encellogu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Datë:10.02.2023

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.69/350-4108

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të nenit 21 të LPH Nr.04/L-174 datë:31.07.2013, nenit 18 të LN Nr.04/L-110 datë:31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 Për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë:09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, e që nuk është në kundërshtim me PZHK 2021-2029, 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021, kontratës për shtiblerjen me kompensim të pasurisë së paluajtshme Nr.LRP.8217/2022 dhe Nr.Ref.1818/2022 datë 20.05.2022 dhe sipas kërkesës Rexhep Nuredin Gashi me përfaqësues "Gjini Construction" SH.P.K nga Suhareka 07Nr.350-4108 datë 16.01.2023 si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA Nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM MBI KUSHTE NDËRTIMORE
(Resula -Suharekë)**

Ky dokument lëshohet për:

Emri:	Rexhep Nuredin Gashi, me përfaqësues "Gjini Constuction" SH.P.K-Suharekë	Kërkesa Bazë:	Kushte Ndërtimore 07Nr.350-4108 datë 16.01.2023
-------	--	------------------	--

Kushte ndërtimore	Sipas Hartës Zonale te Komunës se Suharekës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë28.10.2022
I. Gjendja ekzistuese e lokacionit :	
Zona Kadastrale	Suharekë
Rruga	"Maksut Kuçi" në Lagjen Rosula
Parcela Kadastrale	02934-7
Sipërfaqja e parcelës kadastrale	405 m ²
Sipërfaqja e parcelës ndërtimore	405 m ²
Numri Referues i certifikatave	Nr.131/2023 datë 11.01.2023 dhe kopjes së planit datë 11.01.2023
Përpjesa e Kopjes së planit kadastral	1: 194
Pronësia	pronë private e Rexhep Nuredin Gashi
Objekte ekzistuese brenda parcelës kadastrale:	Brenda parcelave ndërtimore nuk ka objektet ekzistuese
Objekte ekzistuese përreth lokacionit në diametër 50m'	Përreth lokacionit nuk ka objekte banimi

Faqe 2 nga 2

II. Kushte të Ndërtimit për objektin: NDËRTIM I RI, KATEGORIA I - OBJEKT ME NJË NJËSI BANIMI

III. Lokacion në kuadër të: Hartës Zonale të Komunës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022

IV. Kërkesës i janë bashkangjitur dokumentacionet: Çertifikatat dhe kopja e planit, kopjet e letërnjoftimit, kontratës për shtiblerjen me kompensim të pasurisë së paluajtshme Nr.LRP.8217/2022 dhe Nr.Ref.1818/2022 datë 20.05.2022, inçizimin gjeodezik të parcelës kadastrale, projekt propozimi, vërtetimin e tatimit në pronësi 04Nr.439 datë 16.12.2022, çertifikata e regjistrimit të biznesit në emër të investuesit, konceptin e projektit dhe dokumente tjera të nevojshme.

V. Gjendja e planifikuar duke u bazuar në HZK: Lokacioni në të cilin do të ndërtohet objekti është tokë ndërtimore me destinim sipas HZK është sipërfaqe Sub Urbane – ZB3 (Zonë e banimit me një njësi)

Përshkrimi në vazhdim i referohet Tabelës 15 Kushtet ndërtimore për zonën e banimit me një njësi ZB3 (bazuar në propozimin e referuar nga pala)

Destinimi	ZB3		
Lloi i strukturës së ndërtimit	Sipërfaqe Sub Urbane		
Lloji i ndërtesës	Ndërtesë e veçantë		
Vija rregulluese	Nga aksi i profilit të rrugës së planifikuar-kategoria rrugë qasëshe/dy kahëshe 2.75m'		
Vija ndërtimore nga vija rregulluese	E rrugës së planifikuar-kategoria rrugë qasëshe/dy kahëshe min 6.0m'		
Etazhiteti	B+P+2		
Lartësia maksimale e ndërtesës (m)	12 m'		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale përgjat rrugës publike	1.5L/1GJ		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje paraprake me fqinjët	3L/1GJ		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme	4L/1GJ		
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	3L/1GJ		
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapjet	4L/1GJ		
ISHPKZH	25%		
% e gjelbërimit	65%		
SNP	80%		
ISN	0.75		
Kërkesa minimale për vendparking	2VP/100m ²		
Koeficienti minimal i përqeshmëris termike (U-value(W/m ² K))	Muri 0.5	Kulmi 0.3	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db(A)		22:00-08:00=35db(A)
Dendësia maksimale banore/ha	75		
Dendësia maksimale njësi banimi/ha	21		
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m ²)	300		
Thellësia minimale e parcelës kadastrale (m)	20		
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m)	15		

1.10.2022

Te dhëna tjera shtesë rreth kushteve të ndërtimit
Karakteri: Përherëshëm me material të fortë ndërtimor
Shfrytëzimi i objektit: Objekti të shfrytëzohet për destinimin e propozuar nga parashtuesi i kërkesës e cila është në përputhje me zonimin e PZHK-së si dhe HZK-së.
Gabariti: Jo më shumë se 25% nga sipërfaqja e parcelës ndërtimore. Vërejtje: këto sipërfaqe mund të zvogëlohen në rast se kërkojnë kushtet tjera për ndërtimin e objektit.
Qasja në parcelë: Qasja në parcelë me automjete (për parking) lejohet nga rruga e planifikuar dhe duke i respektuar distancat e qasjeve me rrugët publike sipas UA.
Formësimi arkitektonik dhe estetik: 60% e sipërfaqes së fasadës të jetë ngjyrë të bardhë duke mos llogarit sipërfaqen e dritareve. Lejohet 20-40% përdorimi i gurëve apo tullës në fasadë me ngjyrë kafe të kuqe apo të hirtë, tjegullat ngjyre kafe, kornizat e dritareve nga druri apo PVC me tekstur druri ose ngjyrë të zezë duke ja përshtatur materialin ndërtimor zonës së ndërtimit. Forma e objektit preferohet të jetë gjeometrike katrore. Kulmi të jetë 2 apo me shumë ujore, streha e kulmit të jetë me gjatësi deri në 1m. Lejohet jo më shumë se 20% e kulmit të nxjerrën baxha.
Rregullat për zhvillimin e pejsazhit: Gjelbrimi përgjatë rrugëve të jetë me bimë-drunjë të cilat kanë aftësi dhe kapacitet për pejsazhe atraktive dhe rregullator të mjedisit.
Distanca e bodrumit nga parcela fqinje: Bodrumi përdoret për garazhim dhe nevoja ekonomike të objektit sipas rregulloreve në fuqi. Distanca e bodrumit nga parcelat fqinje min. 1.5m' për etazhe (vetëm në rast se nuk ndryshojnë kushtet tjera ndërtimore). Distanca e bodrumit nga rruga mund të jetë me gabarit të njëjtë me përdheshën.
Kuota e përdheshës: Kuota e përdheshës të jetë 30-80cm' mbi nivelin e trotuarit duke i planifikuar hyrjet sipas standardeve për shfrytëzuesit e objektit dhe duke respektuar kushtet ndërtimore të cituara më lartë.
Numri i hyrjeve: Hyrja kryesore
Konzola: Projektohen sipas normave dhe në përputhshmëri me karakterin e objektit
Shkallët: Projektohen sipas normave dhe në përputhshmëri me karakterin e objektit.
E drejta e ndriçimit natyror: Mënyra e projektimit të ndriçimit të bëhet në përputhje me normat teknike të planifikimit duke u bazuar në destinimin e objektit. Hapësirat ekonomike pa hapje natyrale duhet ta kenë sistemin e ventilimit.
Vërejtje: Gjatë hartimit të dokumentacionit teknik për objektin, duhet të respektohet forma e parcelës në raport me objektin, qarkullim efikas, me arkitekturë të qëndrueshme duke i dhënë rëndësi ruajtjes së energjisë dhe reduktimi i ndikimeve negative në mjedis.

VI. Kushtet kyçese në infrastrukturë: Kyçja në infrastrukturë të bëhet në rrejet ekzistuese pas sigurimit të kushteve detale dhe pëlqimeve për kyçje nga: <ul style="list-style-type: none"> a) KEDS- njësia në Suharekë b) Ujësjellësi dhe kanalizimi- kompania Hidroregjioni Jugor njësia në Suharekë c) Mbeturinat- Ekoregjioni në Suharekë d) Pëlqim për kyçje në komunikacion – nga inspektori i komunikacionit e) Koordinatat e vendosjes së objektit sipas kushteve ndërtimore nga gjeodeti i licensuar. f) Pëlqim për shfrytëzimin e rrugëve të planifikuara me Hartë Zonale të Komunës.

VII. Kushtet për rregullimin e parcelës ndërtimore (hapësira): Kushtet përrregullimin e parcelës ndërtimore të paraqiten në mënyrë grafike në përpjesën 1:500, 1:250 dhe të jenë pjesë e projektit kryesor ku do të përmbajnë, etazhitetin, gabaritin e objektit, distancat nga fqinjët, vijën ndërtimore, vijën rregullative, hyrjen, pjerrtësitë e pullazit, dimensionet e parcelës, qasjen në rrugë, parkingun, gjelbërimin, rrethojën e parcelës.

VIII. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë :

- Të dhënat e zyrës projektuese: certifikatën e biznesit, diplomat e inxhinierëve të lëmive përkatëse,
- Deklarata e projektuesit kryesor që projekti është në harmoni me kushtet e dhëna, vendimet dhe rregulloren e komunës si dhe me dispozitat ligjore në fuqi.
- Dokumentacioni i hartuar teknik në përpjesë 1:50 të dorëzohet pranë DUP, në tri kopje origjinale (për palën, dosjen dhe Insp. e ndërtimit) dhe në CD të lidhura (që e mundëson qëndrueshmërinë e tij në kohë) dhe të vulosura nga kompania projektuese e licencuar.
- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës.
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë.
- Përshkrimi teknik me specifikacionin detal të sipërfaqeve bruto dhe neto të objektit (ky dokument është bazë për kalkulimin e sipërfaqes per përshkrim ne Lejen e Ndërtimit)
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhës dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute.
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë.
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20.
- Të gjitha fazat e projektit me paramasa dhe parallogaritë, përshkrime, vizatime dhe detale të nevojshme për zbatimin e projektit në teren.
- I gjithë projekti duhet të jetë i nënshkruar nga projektuesit (inxhinier të diplomuar të profesioneve përkatëse) dhe vërtetuar me vulën e zyrës së projektimit.

Vërejtje: Obligohet projektuesi që hartimin e projektit ta beje në përputhje me HZK-ne, Ligjet e aplikueshme në KS, UA dhe normat në fuqi. Para dorëzimit të projektit një kopje të sjellët në DUP për të kontrolluar se a është në përputhshmëri me kushtet e dhëna. Në qoftë se projekti kryesor nuk i përmbahet kritereve të projektimit, informatave të dhëna me këtë dokument dhe kushteve të definuar me HZK dhe normat tjera të definuara përkëtë kategori te objekteve. do të kthehet në plotësim apo ndryshim.

IX. Këto kushte vlejné 1 vjet duke llogaritur nga data e lëshimit të tyre. Vazhdimi i vlefshmërisë së këtyre kushteve mund të bëhet edhe për një vit tjetër nëse nuk është ndryshuar pjesa e planit të HZK-se në bazë të të cilit është lëshuar ky dokument.


Vërejtje: Pala duhet që me së voni një muaj para skadimit të afatit të filloi procedurën e marrjes së Lejes së Ndërtimit, në të kundërtën kushtet nuk janë të vlefshme nëse e kalon afatin një vjeçar dhe pala duhet të i nënshtrohet riprocedimit.

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtyre kushteve pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në MMPHI brenda afatit prej 30ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes së dokumentit.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
Numri i vrojtimit i lejes 07N.69/350-4108 datë 10.02.2023, Suharekë

Informata i dërgohet:

Palës,
Inspektoratit të ndërtimit,
Dosjes së DUP-së,
Arkivit të Komunës.



FUNDI